

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVEBULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

QERSHOR, 2025

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin qershor 2025 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit qershor 2025 zënë 36 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 227.4/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 0.56/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin qershor 2025 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin qershor 2025
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste Qershor 2025	Incidenca Qershor 2025 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.03
Salmoneloza	20	0.70
Shigelozë (Disenteri bacilare)	7	0.24
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	16	0.56
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6466	225.89
Sëmundje diarreike në total	6510	227.43

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar në total 100 raste variçelë (incidenca 3.5/ 100.000 banorë) nga të cilat, 97 raste janë të dyshuara dhe 3 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 30 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç dhe 4-9 vjeç me 35 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës




2.2 Fruthi

Gjatë muajit qershor nuk është raportuar asnjë rast me fruth.

Muaj	Nr. rastesh	Incidenca
Janar	1	0.04
Shkurt	3	0.12
Mars	10	0.42
Prill	0	0
Maj	1	0.04
Qershor	0	0

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas datës të fillimit të rashit



Siç shihet dhe nga grafiku gjatë muajit qershor nuk është konfirmuar asnjë rast me fruth.


3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin qershor janë raportuar 62 raste të dyshuar nga të cilat janë konfirmuar 38 (61.2%) raste me HBV. Incidenca e HBV në muajin qershor është 1.6 raste/100 000 banorë në vend. Prej tyre 20 janë të gjinisë mashkull (53%) dhe 18 femra (47%).


Muaj	Incidenca	Nr. rastesh
Janar	0.8	20
Shkurt	1.4	34
Mars	1.2	29
Prill	1.3	32
Maj	1.4	34
Qershor	1.6	38

Grafiku 3. Shpërndarje e rasteve me HBV sipas bashkive dhe muajve



Në muajin qershor rastet janë të shpërndara në disa bashki (grafiku 1) ku numrin më të lartë e kanë Durrësi me 12 raste.

Grafiku 4. Shpërndarje e rasteve me HBV sipas grup-moshave (vite)




Rastet në muajin qershor i përkasin grup-moshës adulte mbi 30 vjeç (grafiku 2) dhe mungesë e tyre në grup-moshat pediatrike, kjo në sajë të vaksinimit ndaj HBV në këto grup-mosha.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin qershor janë raportuar 17 raste të dyshuar nga të cilat janë konfirmuar 6 (35.2%) raste me HCV. Incidenca e HCV për këtë muaj është 0.25 raste /100000 banorë. Prej tyre 5 (83.3%) janë të gjinisë mashkullore dhe 1 femër (16.7%).


Muaj	Raste	Incidenca
Janar	3	0.12
Shkurt	5	0.21
Mars	6	0.25
Prill	6	0.25
Maj	5	0.21
Qershor	6	0.25

Grafiku 5. Shpërndarje e rasteve me HCV sipas bashkive dhe muajve



Rastet i përkasin bashkisë Elbasan 5 dhe Tiranë 1 (grafiku 5).

Grafiku 6. Shpërndarje e rasteve me HCV sipas grup-moshave (vite)




Rastet janë të grup-moshave adulte mbi 35 vjeç (grafiku 6).

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit qershor 2025 janë kryer 34 ekzaminime për HIV (24 meshkuj dhe 10 femra) prej të cilëve 13 raste (12 meshkuj dhe 1 femër) kanë rezultuar HIV pozitiv (Grafiku 7).

Grafiku 7. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin qershor 2025.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është: 1 rast Divjakë (Lushnjë), 1 rast Korçë, 10 raste Tiranë (nga të cilët 2 raste janë me shtetësi të huaj) dhe 1 rast Vlorë (Grafiku 8).

Grafiku 8. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara në muajin qershor 2025



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 2 raste i përkasin grup-moshës 16-24 vjeç, 6 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç dhe 5 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 4 raste nga QSUT (3 raste nga Shërbimi Infektiv dhe 1 rast nga Pavioni i Neurologjisë), 4 raste vijnë nga laboratorë/spitale private (2 raste INTERMEDICA dhe 2 raste nga Cambridge), 2 raste referuar si donator gjaku nga QKTGJ, 1 rast nga burgu dhe 2 raste nga DSHP (1 Vlorë dhe 1 Tiranë).

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 7 raste të konfirmuara me Sifiliz.

Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 2 meshkuj e 5 femra. Shpërndarja sipas grup-moshave është 3 raste për grup-moshën 25-34 vjeç, 2 raste për grup-moshën 15-24 vjeç dhe nga një rast për grup-moshat 45-54 vjeç dhe 55-64 vjeç.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar gjithsej 17 raste me tuberkuloz (TB), nga të cilat 14 raste janë pulmonarë dhe 3 raste janë ekstrapulmonarë. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara pozitivë. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 8 në Tiranë, 2 në Lushnjë, 1 në Korçë, 1 në Elbasan dhe 2 në Bulqizë. (total 14) Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë: 2 në Tiranë dhe 1 në Elbasan (total 3). Këtë muaj kemi 2 raste recidiv. Raste recidive janë përkatësisht: 1 në Lushnjë dhe 1 në Lezhë. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 5. Shpërndarja e zoonozave në muajin qershor 2025, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Qershor(raste 2025)	Incidenca (raste/100,000) 2025
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	11	0.38
Leptospirozë	0	0.00

Për muajin qershor janë raportuar 11 raste Brucelozë përkatësisht:1 në Tepelenë, 3 në Dibër, 2 në Gjirokastrë dhe 3 në Kukës, 1 në Mat dhe 1 në Pogradec.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

Gjatë muajit qershor 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 9 raste të konfirmuara me COVID-19. Konfirmimi i rasteve është bërë me test të shpejtë.

Shpërndarja sipas grup-moshave është nga 1 rast për grup-moshat 25-34 vjeç, 15-24 vjeç, 65-74 vjeç, 75+ vjeç dhe 3 raste për grup-moshën 45-54 vjeç dhe 2 raste për grup-moshën 55-64 vjeç.

7.2 Grip

Gjatë muajit qershor nuk ka raste të konfirmuara me Grip.

8. Sëmundje të tjera

Meningit Bakterial

Gjatë muajit qershor 2025, janë raportuar gjithsej tre raste me meningit bakterial: dy raste nga Spitali Infektiv Tiranë dhe një rast nga Durrësi. Dy prej rasteve i përkasin grup-moshës 5–10 vjeç dhe një rast është në grup-moshën 50–60 vjeç, të gjitha të gjinisë mashkull. Rastet janë regjistruar nga Tirana, Shkodra dhe Durrësi. Shërbimet përkatëse të epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor pranë NJVKSH-ve respektive kanë kryer hetimin epidemiologjik në vatër dhe kanë marrë të gjitha masat e nevojshme parandaluese dhe kontrolluese.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI